**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**BASHKIA GRAMSH**

Gramsh, më 14.10.2025

# NJOFTIM PËR KONSULTIM PUBLIK

Propozim për shpalljen e Monumenteve të Natyrës në territorin e Bashkisë Gramsh

Në bazë të ligjit nr. 146/2014 "Për njoftimin dhe konsultimin publik", të nenit 12 të ligjit nr. 81/2017, datë 04.05.2017 "Për zonat e mbrojtura", të ndryshuar, si dhe në vijim të shkresës nr. 300 Prot., datë 10.10.2025 të Ministrisë së Mjedisit, Bashkia Gramsh publikon për konsultim publik propozimet për shpalljen e Monumenteve të Natyrës të kategorisë III të mbrojtjes në territorin e saj.

Monumentet e propozuara për shpallje:
1. **Shpella e Barutit dhe Kecave të Vegjël** – me sipërfaqe 1,110.73 m²
2. **Shpella Pusi i Avullit** – me sipërfaqe 222.42 m²

Ftesë për konsultim publik

Qytetarët, organizatat mjedisore, dhe palët e interesuara janë të ftuar të paraqesin komente, vërejtje apo sugjerime brenda afatit 30 ditë nga data e publikimit të këtij njoftimi.

Vërejtjet mund të dërgohen:
- Në adresën fizike: Bashkia Gramsh, BLV "10 Korriku", sheshi "Kamber Dermyshi"
- Në adresën elektronike: www.bashkiagramsh.gov.al
- Ose me postë, me subjektin: "Konsultim publik për Monumentet e Natyrës"

Pas përfundimit të afatit ligjor, në mungesë të kundërshtimeve, Bashkia Gramsh do të përcjellë mendimin përfundimtar pranë Ministrisë së Mjedisit për miratimin e shpalljes së këtyre monumenteve.

Bashkëlidhur mund të shkarkoni:
- Shkresën shoqëruese të Ministrisë së Mjedisit (nr. 300, datë 10.10.2025)
- Skedat përshkruese të monumenteve
- Koordinatat gjeografike
- Formularin për komentet e publikut

**Ju mirëpresim për konsultim publik.**

- Zh. Mjedisit
- Zh. Turizmit

4525
10.10.2025

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
**MINISTRIA E MJEDISIT**
**DREJTORIA E PËRGJITHSHME PER ZHVILLIMIN E MJEDISIT**
**DREJTORIA E NATYRES DHE PYJEVE**

Nr.300 prot. Tiranë, më 8.10.2025

Lënda: Shkresë përcjellëse

**BASHKISË ELBASAN**
Rruga 11 Nëntori, Elbasan

**BASHKISË PRRENJAS**
Rruga Skenderbej,

**BASHKISË GRAMSH**
BLV "10 Korriku", sheshi "Kamber Dermyshi"

**BASHKISË LIBRAZHD**
Sheshi Gjorg Golemi

Në kuadër të rivlerësimit të listës së Monumenteve të Natyrës, i realizuar nga Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura, është kryer procesi i rishikimit dhe vlerësimit të çdo Monumenti të Natyrës i shpallur në Republikën e Shqipërisë me Vendimin nr. 303, datë 10.05.2019, të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e listës së rishikuar, të përditësuar, të monumenteve të natyrës shqiptare", i ndryshuar. Rivlerësimi është realizuar në bazë të pikës 5 të nenit 17 të ligjit 81/2017 "Për zonat e mbrojtura" i ndryshuar dhe ka patur për qëllim të sigurojë përputhshmëri me parametrat e mbrojtjes së biodiversitetit dhe ruajtjen e vlerave natyrore, shkencore, estetike dhe kulturore.

Realizimi i rivlerësimit të monumenteve të natyrës është kryer mbi bazën e një metodologjie të integruar, që kombinon analizën hapësinore gjeografike, vlerësimin ekologjik, kriteret ligjore dhe standardet ndërkombëtare për mbrojtjen e elementeve natyrore me rëndësi të veçantë. Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura, gjatë procesit të rishikimit të Monumenteve të Natyrës, ka propozuar gjithashtu zgjerimin e listës ekzistuese.

vendore.

Monumentet e propozuara për shtim, të shpërndara në të gjithë territorin e vendit, plotësojnë

ose më shumë nga kriteret e mëposhtme:

- **Vlera natyrore të spikatura**: elemente unike të peizazhit, formacione gjeologjike, burime ujore, pyje monumentale apo habitate të rralla.
- **Vlera shkencore**: zona që ofrojnë potencial të lartë për kërkime, studime dhe monitorim afatgjatë të biodiversitetit.
- **Vlera estetike**: objekte që kontribuojnë ndjeshëm në identitetin vizual dhe turistik të rajonit.
- ~~**Vlera kulturore**: elemente natyrore të lidhura me tradita, legjenda apo histori vendore.~~

Përzgjedhja u bë duke respektuar parimet e përfaqësimit gjeografik dhe ekologjik, në mënyrë që rrjeti i Monumenteve të Natyrës të mbulojë një spektër më të gjerë ekosistemesh dhe tipologjish natyrore.

Gjatë vlerësimit të monumente ekzistuese në Qarkun e Elbasanit nga Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura janë propozuar edhe:

| | | |
|---|---|---|
| Shpella e Mbytjes Krrabë e Vogël (Funar) | 199.62 | Elbasan |
| Lule Helmi Shiptar | 6,315.89 | Elbasan |
| ~~Shpella e Barutit dhe Kecave të Vegjël~~ | ~~1,110.30~~ | ~~Gramsh~~ |
| Kanioni i Menikut | 3,149.79 | Prrenjas |
| Shpella Pusi i Avullit | 222.42 | Gramsh |
| Shpella e Plakës (Dardhë-Xhyrë) | 379.58 | Librazhd |

për tu bërë pjesë në listën e "Monumenteve natyrore" kategoria e III e mbrojtjes.

Në bazë të nenit 10 të ligjit nr. 81/2017 "Për zonat e mbrojtura" i ndryshuar, shpallja e zonave të mbrojtura mjedisore bëhet në përputhje me planin kombëtar të zonave të mbrojtura, pas marrjes së mendimit të institucioneve akademike e shkencore në vend, dhe të bashkisë brenda territorit administrativ të të cilës ndodhet zona.

Sipas pikës d dhe dh të nenit12 të të njëjtit ligj, plani i shpalljes së zonave të mbrojtura mjedisore publikohet në faqen zyrtare të ministrisë përgjegjëse për zonat e mbrojtura dhe në bashkinë apo qarkun ku ndodhet zona që propozohet të shpallet.

Brenda një muaji nga dita e shpalljes së planit të zonave të mbrojtura, të interesuarit mund të bëjnë vërejtje e sugjerime, të cilat i paraqiten ministrisë përgjegjëse për zonat e mbrojtura. Me kalimin e këtij afati dhe nëse nuk ka pasur vërejtje e kundërshtime, plani quhet i miratuar dhe në bazë të tij, ministria përgjegjëse për zonat e mbrojtura fillon procedurat për përgatitjen dhe paraqitjen e projektvendimit për shpalljen e zonave të mbrojtura mjedisore.

Në vijim sa më sipër, lutemi publikimin e propozimeve për shpalljen e Monumenteve të Natyrës pranë Bashkive, si dhe dhënien e mendimit tuaj lidhur me përfshirjen e tyre në listën e "Monumenteve Natyrore" në kategorinë III të mbrojtjes.

Bashkëlidhur gjeni skedën dhe koordinatat e monumenteve.

Duke ju falënderuar për mirëkuptimin,

**SEKRETAR I PËRGJITHSHËM**
**Ledina BEQIRAJ AGALLIU**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - MINISTRIA E MJEDISIT

Propozim i ri për shtim në listën e monumenteve

| | | |
|---|---|---|
| Shpella e Barutit dhe Kecave të Vegjël (propozim i ri) | 1,110.30 | Gramsh |
| Kanioni i Menikut (propozim i ri) | 3,149.79 | Prrenjas |
| Shpella e Mbytjes Krrabë e Vogël (Funar) (propozim i ri) | 199.62 | Elbasan |
| Lule Helmi Shqiptar (propozim i ri) | 6,315.89 | Elbasan |
| Shpella Pusi i Avullit (Propozim i ri) | 222.42 | Gramsh |
| Shpella e Plakës (Dardhë-Xhyrë) (propozim i ri) | 379.58 | Librazhd |

Janë paraqitur 6 propozime të reja për t'u shtuar në listën e monumenteve të natyrës, për vlerat e veçanta që mbart si më poshtë:

**Shpella e Barutit dhe Kecave të Vegjël**



Shpella e Barutit dhe Kecave të Vegjël ndodhet në zonën malore në afërsi të kanionit të Holtës, Bashkia Gramsh, Qarku Elbasan, në një lartësi 324 m mbi nivelin e detit. Shpella është e formuar në shkëmbinjtë gëlqeroë të kretës së sipërme me një gjatësi 1597 m, gjerësi: 16-20 m dhe lartësi të dhomave: 25 m. Biospeleologët kanë zbuluar nje faunë të bollshme, ku dominojne lakuriqët e natës që jane të shumtë në koloni. Nga rëndësia ekologjike, shpella konsiderohet si habitat për specie të rralla dhe të rrezikuara. Vizitohet duke ndjekur interarin e rrugës automobilistke Gramsh-Tervol- duke ndjekur shtegun e dhive për të shpella





**Shpella Pusi i Avullit**



Shpella Pusi i Avullit ndodhet në afërsi të Kanionit të Holtës, Bashkia Gramsh, Qarku Elbasan, në lartësinë 710 m mbi nivelin e detit. Shpella ka përbërje karstike me një gjatësi 6,8m dhe gjerësi 16-20m. Nga një vrojtim fillestar, jane identifikuar burime të ndryshme squfuri, shumica e të cilave dalin në bazën e mureve të kanionit. Qasja në rrjedhën e poshtme të grykës karakterizohet nga 2 pishina kryesore squfuri, me ujë me pamje qumështi. Biospeleologët kanë zbuluar një faunë të bollshme në pjesën e poshtme të hyrjes vertikale, falë bollëkut të lëndëve organike që vijnë nga sipërfaqja, dhe në pjesën aktive (squfuri) të shpellës, e cila është jashtëzakonisht e pasur për shkak të pranisë së kolonive të shumta bakteriale që janë në bazën e zinxhirit të ushqimit. Në fund në liqenin squfur ka qindra - mijëra amfipodë, ndërsa në brigjet e tij llojshmëri insektesh. Sipas analizave fillestare, duket se ka të paktën dy lloje të reja amfipodësh dhe të paktën një ose ndoshta dy lloje të reja koleopterësh. Lakuriqët e natës gjithashtu jane të shumtë. Shpella shërben si një habitat për specie të rralla dhe të rrezikuara. Stalagtidet dhe stalagmidet e larmishme dhe shume të zhvilluara me bukuri e forma të mrekullueshme, dominojnë shpellën. Vizitohet duke ndjekur interarin e rrugës automobilistike Gramsh- Drizë- Kabash (Lagje Toskollar). Theksojmë që shpella është e aksesueshme vetëm nga speleologë dhe persona të tjerë të specializuar në përdorimin e litarëve pasi shpella ka disa nivele me puse vertikale për të arritur fundin në -476 m.

| | | |
|---|---|---|
| 518872.1 | 4532379 | 1 Shpella e Barutit dhe Kecave të Vegjël |
| 518871.9 | 4532398 | 2 Shpella e Barutit dhe Kecave të Vegjël |
| 518875.2 | 4532397 | 3 Shpella e Barutit dhe Kecave të Vegjël |
| 518878.3 | 4532397 | 4 Shpella e Barutit dhe Kecave të Vegjël |
| 518881.3 | 4532395 | 5 Shpella e Barutit dhe Kecave të Vegjël |
| 518884.1 | 4532393 | 6 Shpella e Barutit dhe Kecave të Vegjël |
| 518886.4 | 4532391 | 7 Shpella e Barutit dhe Kecave të Vegjël |
| 518888.3 | 4532388 | 8 Shpella e Barutit dhe Kecave të Vegjël |
| 518889.8 | 4532385 | 9 Shpella e Barutit dhe Kecave të Vegjël |
| 518890.6 | 4532382 | 10 Shpella e Barutit dhe Kecave të Vegjël |
| 518890.9 | 4532379 | 11 Shpella e Barutit dhe Kecave të Vegjël |
| 518890.7 | 4532376 | 12 Shpella e Barutit dhe Kecave të Vegjël |
| 518889.9 | 4532373 | 13 Shpella e Barutit dhe Kecave të Vegjël |
| 518888.5 | 4532370 | 14 Shpella e Barutit dhe Kecave të Vegjël |
| 518886.7 | 4532367 | 15 Shpella e Barutit dhe Kecave të Vegjël |
| 518884.4 | 4532364 | 16 Shpella e Barutit dhe Kecave të Vegjël |
| 518881.7 | 4532363 | 17 Shpella e Barutit dhe Kecave të Vegjël |
| 518878.8 | 4532361 | 18 Shpella e Barutit dhe Kecave të Vegjël |
| 518875.6 | 4532360 | 19 Shpella e Barutit dhe Kecave të Vegjël |
| 518872.3 | 4532360 | 20 Shpella e Barutit dhe Kecave të Vegjël |
| 518869 | 4532360 | 21 Shpella e Barutit dhe Kecave të Vegjël |
| 518865.8 | 4532361 | 22 Shpella e Barutit dhe Kecave të Vegjël |
| 518862.9 | 4532362 | 23 Shpella e Barutit dhe Kecave të Vegjël |
| 518860.2 | 4532364 | 24 Shpella e Barutit dhe Kecave të Vegjël |
| 518857.8 | 4532367 | 25 Shpella e Barutit dhe Kecave të Vegjël |
| 518855.9 | 4532369 | 26 Shpella e Barutit dhe Kecave të Vegjël |
| 518854.5 | 4532372 | 27 Shpella e Barutit dhe Kecave të Vegjël |
| 518853.6 | 4532375 | 28 Shpella e Barutit dhe Kecave të Vegjël |
| 518853.3 | 4532379 | 29 Shpella e Barutit dhe Kecave të Vegjël |
| 518853.5 | 4532382 | 30 Shpella e Barutit dhe Kecave të Vegjël |
| 518854.3 | 4532385 | 31 Shpella e Barutit dhe Kecave të Vegjël |
| 518855.7 | 4532388 | 32 Shpella e Barutit dhe Kecave të Vegjël |
| 518857.5 | 4532391 | 33 Shpella e Barutit dhe Kecave të Vegjël |
| 518859.8 | 4532393 | 34 Shpella e Barutit dhe Kecave të Vegjël |
| 518862.5 | 4532395 | 35 Shpella e Barutit dhe Kecave të Vegjël |
| 518865.4 | 4532396 | 36 Shpella e Barutit dhe Kecave të Vegjël |
| 518868.6 | 4532397 | 37 Shpella e Barutit dhe Kecave të Vegjël |
| 518871.9 | 4532398 | 38 Shpella e Barutit dhe Kecave të Vegjël |

| | | |
|---|---|---|
| 519167.8 | 4533003 | 1 Shpella Pusi i Avullit |
| 519170.9 | 4533003 | 2 Shpella Pusi i Avullit |
| 519173.8 | 4533001 | 3 Shpella Pusi i Avullit |
| 519175.7 | 4533000 | 4 Shpella Pusi i Avullit |
| 519177.1 | 4532997 | 5 Shpella Pusi i Avullit |
| 519177.6 | 4532995 | 6 Shpella Pusi i Avullit |
| 519177.5 | 4532992 | 7 Shpella Pusi i Avullit |
| 519176.2 | 4532990 | 8 Shpella Pusi i Avullit |
| 519174.6 | 4532988 | 9 Shpella Pusi i Avullit |
| 519172.5 | 4532987 | 10 Shpella Pusi i Avullit |
| 519170.1 | 4532986 | 11 Shpella Pusi i Avullit |
| 519168 | 4532986 | 12 Shpella Pusi i Avullit |
| 519165.5 | 4532987 | 13 Shpella Pusi i Avullit |
| 519163.3 | 4532988 | 14 Shpella Pusi i Avullit |
| 519162.4 | 4532990 | 15 Shpella Pusi i Avullit |
| 519161.4 | 4532992 | 16 Shpella Pusi i Avullit |
| 519161 | 4532995 | 17 Shpella Pusi i Avullit |
| 519160.8 | 4532998 | 18 Shpella Pusi i Avullit |
| 519162 | 4533000 | 19 Shpella Pusi i Avullit |
| 519164.3 | 4533002 | 20 Shpella Pusi i Avullit |
| 519167.8 | 4533003 | 21 Shpella Pusi i Avullit |
| 519169.4 | 4532995 | 22 Shpella Pusi i Avullit |